

TEMATIKAT E DEBATIT UNIVERSITAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Hyrje

Bazuar në përshkrimin e projektit tematikat e debatit do të fokusen në tre shtylla kryesore:

1 – Procesi i integrimit dhe anëtarësimit për Shqipërinë në BE sipas 5 prioritetëve kryesore

- Reforma në administratën publike
- Mbrojtja e të drejtave të njeriut
- Lufta kundër korrupsionit
- Lufta ndaj krimit të organizuar
- Zbatimi i reformës në drejtësi

2 – Ndikimi i pritshëm i anëtarësimit të Shqipërisë në BE në:

- fushën e ekonomisë dhe zhvillimit teknologjik
- tregut të punës dhe konkurrencës
- bujqësisë dhe agro-biznesit/turizmit
- arsimit dhe shkencës

3 – Sfidat aktuale në BE:

- zgjerim apo thellim
- populizmi
- migracioni
- Inteligjenca artificiale

Gjatë trajnimit të pedagogëve u diskutuan me detaje tematikat dhe mundësitë për tu realizuar me sukses nga studentët dhe u dakordësua që temat të jenë të fokusuar në disa çështje konkrete dhe të prekshme. Për më tepër duhet mbajtur parasysh që studentët janë të fushave të ndryshme (psh një studentë i financës nuk ka të njëjtën përgatitje si ai i shkencave politike për emigracionin apo indentitetin europian) dhe kështu tematikat duhet të jenë edhe gjithëpërfshirëse dhe që mos të kërkojnë shumë njohuri të specializuara. Gjatë trajnimit të pedagogëve u dakordësua që studentët do të kenë 5 tema për të cilat do të mund të përgatiten paraprakisht përmes paketës kërkimore dhe 5 tema të tjera që do të jenë të lira dhe më të përgjithshme.

Debati i parë me tematikat me përgatitje zgjat 20 minuta. Debati i dytë me tematika të lira zgjat 10 minuta dhe peshën më të mëdha e mbajnë liderët dhe folësit II të të dyja skuadrave.



Temat duhet të jenë të kuptueshme, jo evazive, jo komplekse; Të jenë konkrete për Shqipërinë dhe debatet aktuale në Bashkimin Europian; Të lejojnë mbajtjen e qendrimeve pro dhe kundra; të krijojnë hapësirë për debat / rrahje mendimesh; të mos jenë paragjyquese, diskriminuese, të një-anshme; të respektohen rregullat etike të komunikimit.

Temat me përgatitje për debatin universitar për integrimin

‘Integrimi europian thellon dhe përmirëson demokracinë në Shqipërisë’

‘Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian rrezikon të ardhmen e produkteve dhe shërbimeve vendase’

‘Anëtarësimi në Bashkimin Europian sjell zhvillim ekonomik për vendin’

‘Lëvizja e lirë në Bashkimin Europian për të jetuar, për tu arsimuar dhe për të punuar do të shkaktojë krizë demografike në Shqipëri’

‘E ardhmja e Bashkimit Europian është zgjerimi, jo thellimi’

